REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.09.2015, ora 10:00 – 10:52

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Europa për qytetarët".

2. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë dhe projektit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë "Huamarrësi", të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Fondit Shqipëtar për Zhvillim, "Agjencia e zbatimit të projektit", dhe KfW Frankfurt am Main, "KFW", për shumën 24 milionë euro "Ujësjellësi Rural III"

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Ridvan Bode, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Andrea Marto, Blerina Gjylameti, Ervin Koçi, Evis Kushi, Ervin Bushati, Gledion Rehovica, Gjovalin Kadeli, Luan Duzha, Jorida Tabaku, Igli Cara, Florion Mima, Sherefedin Shehu, Edmond Spaho, Liliana Elmazi, Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Koço Kokëdhima.

I ftuar:

Benet Beci – drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Sot në rendit e ditës të punës së këtij komisioni janë këto çështje.

Së pari, projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Europa për qytetarët". Relatori i komisionit për këtë projektligj është zonja Blerina Gjylameti.

Së dyti, projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë dhe projektit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë "Huamarrësi", të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Fondit Shqipëtar për Zhvillim, "Agjencia e zbatimit të projektit", dhe KfW Frankfurt am Main, "KFW", për shumën 24 milionë euro "Ujësjellësi Rural III". Relator për këtë projektligj është deputeti Ervin Bushati.

Meqenëse për projektligjin e parë personi i ftuar në këtë komision nuk ka gjetur ende kohën për t'u paraqitur fillojmë me çështjen e dytë.

Urdhëroni!

Për të prezantuar projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë dhe projektit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë "Huamarrësi", të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Fondit Shqipëtar për Zhvillim, "Agjencia e zbatimit të projektit", dhe KfW Frankfurt am Main, "KFW", për shumën 24 milionë euro "Ujësjellësi Rural III", ndodhet në Komisionin e Ekonomisë, zoti Benet Beci, drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Zoti Beci, do të fillojmë me prezantimin tuaj dhe më pas me relatorin e komisionit.

Benet Beci – Faleminderit, zoti kryetar! Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sot prezantojmë programin e ujësjellësve numër 3. Është faza e tretë e një programi të nisur para disa vitesh me fazën e parë dhe të dytë. Në fakt, është një program që qëndron më vete, me objektiva të veçanta, por në ngjashmëri me dy programet e para sjell gjithë eksperiencën më të mirë në bashkëpunimin me KfW-në në drejtim të financimit të ujësjellësve ruralë.

E gjithë paketa e financimit për objektivin e projektit është afërsisht 40 milionë euro dhe është e kompozuar nga një kredi, që kalojmë sot, prej 24 milionë eurosh. Është një grant prej 9,8 milionë eurosh i Komitetit Europian si pjesë e paketës së financimit dhe është një grant nga KfW-ja prej 1,5 milionë eurosh dhe një kontribut i qeverisë shqiptare prej 4 milionë eurosh. E gjithë paketa shkon rreth 40 milionë euro për financimin e objektivit kryesor të projektit për përmirësimin me ujë të zonave rurale me afërsisht një numër përfituesish prej 75 mijë banorësh të ndarë në mënyrë të përafërt në 70 skema ujësjellësish ruralë.

Programi është i shtrirë në të gjithë Shqipërinë dhe parashikohet që në pesë vjet të realizohet i gjithë implementimi i ujësjellësve të parashikuar. Veçoria e këtij financimi bazuar edhe në eksperiencat e mëparshme është se ne parashikojmë që të sjellim ujësjellës ruralë të qëndrueshëm, të vetëqëndrueshëm dhe bashkë me to njëkohësisht edhe trajnimin dhe menaxhimin e të gjithë ekipeve që do të jenë përgjegjës për ujësjellësit ruralë.

Kemi disa kushte për përzgjedhjen e ujësjellësve: Në radhë të parë grupi i ujësjellësve do të jetë kryesisht me gravitet, por në rast të veçantë edhe me sistem pompimi dhe kjo për faktin që skemat me gravitet të ujit sigurojnë një qëndrueshmëri më të lartë të financimit dhe të ujësjellësve për arsye që përdoren me kosto më të ulët.

Një kusht për përzgjedhjen e ujësjellësve është bashkëfinancimi me 10% me pushtetin vendor. Kostoja për banor do të jetë më e ulët se 350 euro dhe kryesisht do të jetë për fshatra më të mëdhenj se 200 banorë. Janë disa nga kushtet e përzgjedhjes së ujësjellësve që do të financohen.

Programi ndahet në tri faza: Faza e parë është përgatitja e fizibilitetit teknik, që aktualisht është në proces tenderimi dhe përzgjedhja e konsulencës që përgatit fizibilitetin teknik. Më pas parashikojmë rreth gjashtë muaj deri në një vit që do të jetë përgatitja e projekteve teknike të ujësjellësve dhe implementimi i tyre do të zgjasë për dy vjet.

Parashikohet që ujësjellësit të jenë të një cilësie shumë të lartë dhe janë të projektuar për një periudhë 30-vjeçare funksionimi. Më kryesorja është se do të jenë ujësjellës, të cilët nuk do të kenë nevojë të subvencionohen nga shteti, do të jenë ujësjellës të vetëqëndrueshëm, të cilët do të paguhen dhe të mirëmbahen mbi bazën tarifave të vendosura.

Ko është pak a shumë një përmbledhje e programit që po kalojmë sot përpara jush.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Beci! Zoti Bushati, si relator i komisionit!

Ervin Bushati - Faleminderit!

Kam një saktësim: Objekti duhet të zëvendësohet nga ujësjellësi ruralë numër 3 me furnizimit me ujë të zonave ruralë numër 3.

Kjo marrëveshje është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave më 17 dhjetor 2014. Bazë për këtë marrëveshje është marrëveshja qeveritare midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar.

Marrëveshja parashikon marrjen e një huaje prej 24 milionë eurosh nga KFW-ja, e cila do të përdoret për fazën e tretë për rehabilitimin dhe ndërtimin e furnizimit me ujë të zonave rurale. Marrëveshja parashikon edhe marrjen e masave urgjente plotësuese për ndotjen e ujit nëse do të paraqitet nevoja.

Termat e huas janë: periudha e maturimit 15 vjet nga të cilat 4 vjet pa pagesë principali, norma e interesit është fikse dhe do të llogaritet një ditë bankare pas ratifikimit të marrëveshjes nga

Kuvendi; tarifa e angazhimit 0,5% në vit për shumat e padisbursuara të huas si edhe tarifa e menaxhimit 1% e shumës së huas.

Agjencia e zbatimit të projektit është FSHZH-ja. Projekti është parashikuar në kuadrin afatmesëm buxhetor 2015-2017 të këtij fondi në programin "Mbështetje për sistemimin me ujë të zonave rurale".

Ky projekt ka nisur të zbatohet që prej vitit 2008. Punimet për fazën e parë dhe të dytë janë kryer dhe janë në përfundim. Gjatë dy fazave të para është përdorur një fond prej 11,7 milionë eurosh, me të cilat janë përmirësuar skemat e ujësjellësve në zonat e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës.

Gjatë fazës së tretë nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të rehabilitohen dhe do të rindërtohen rreth 70 skema në fshatra, të cilat shtrihen në të gjithë vendin dhe kanë numër të lartë dhe të qëndrueshëm popullsie.

Qëllimi i projektit është furnizimi me ujë të pijshëm i popullsisë, si edhe marrja e masave plotësuese për ujërat e zeza në rast se paraqitet nevoja, ndërkohë që tarifat që do të paguajnë konsumatorët do të jenë të tilla që të mbulojnë kostot e furnizimit me ujë.

Kostoja totale e fazës së tretë do të jetë 39,3 milionë euro dhe përveç huas nga KfW-ja, do të financohet nga fondet IPA, nga fondi i përbashkët europian për Ballkanin Perëndimor, si edhe nga një bashkëfinancim i buxhetit të shtetit dhe njësive të qeverisjes vendore përfituese.

Në përfundim, marrëveshja do të ndihmojë në furnizimin me ujë të zonave rurale në të gjithë vendin tonë. Fondet buxhetore për këtë marrëveshje janë parashikuar në ligjin e buxhetit vjetor. Gjithashtu, marrëveshja është në përputhje me kuadrin ligjorë për huamarrjen në vendin tonë. Për këto arsye i propozoj komisionit miratimin projektligjit.

Faleminderit!

Erion Braçe - Faleminderit! Ka pyetje? Po, zoti Spaho!

Edmond Spaho - Ju thatë që ujësjellësit do të kenë si kriter qëndrueshmërinë. Si do ta gjykoni këtë, pasi niveli aktual i çmimit të ujit në pjesën dërrmuese të ujësjellësve i nxjerr të paqëndrueshëm? Po më pas, si do ta kontrolloni, se në letra del i qëndrueshëm, por kur të fillojë të funksionojë çfarë parametrash të detyrueshëm do të ketë që kapet qëndrueshmëria?

Benet Beci - Në fakt, projekti është kompozuar në një fazë paraprake shumë të fortë të studimit në ndryshim nga mënyra e zakonshme të të bërit të investimeve. Pra, faza e përzgjedhjes dhe e fizibilitetit në vetvete nxjerr këtë element. Nëse është e mundur ai ujësjellës që ne kemi përzgjedhur, e para teknikisht duhet të mbajë veten, që do të thotë që kostot e përdorimit të jenë të ulëta dhe kushti i parë për të është graviteti. Të gjithë ujësjellësit që vijnë me gravitet paraprakisht kanë një kosto shumë më të ulët se ato që vijnë me pompa.

Faza e dytë është vlerësimi teknik i kostove, i përfituesit dhe nxjerrja e çmimit që bëhet që në fazën e përllogaritjeve përpara se të merret vendimi nëse do të investojmë në një ujësjellës.

Nga studimi paraprak ne do të dimë kostot me të cilat do të prodhohet uji nga nevoja e shërbimit, që bëhet si studim më përpara, nga mirëmbajtja, menaxhimi, numri i matësve, përdoruesit, pra paraprakisht na jepen të dhëna nëse duhet apo jo që të hyjmë në investim. Kjo njëkohësisht shoqërohet edhe me menaxhimin.

Ne kemi eksperimentuar sepse kemi pasur dy projekte pilot më parë, pra faza e parë dhe dytë që janë shumë të suksesshme dhe deputetët duhet ta dinë për zonat që ata kanë dhe suksesi është jo vetëm që janë realizuar teknikisht mirë, por kemi sigurinë që ato nuk kanë nevojë të subvencionohen dhe funksionojnë brendapërbrenda komunave.

Kështu që, në procedurat tona dhe në rregullat e përzgjedhjes kemi vlerësimin paraprak para hyrjes së investimit dhe përcaktimin e çmimit që do të mbulojë edhe kostot e nevojshme të mirëmbajtjes.

Erion Braçe – Ka pyetje?

Ervin Bushati – Kam një pyetje, duke marrë shkas edhe nga pyetja e parafolësit.

A ka një studim apo keni filluar të bëni rikonjicion duke marrë shkas edhe nga ndarja e re territoriale? Pra, jemi para faktit që sot kemi bashki të reja, të cilat nuk trajtohen më si komuna ose mund të ketë komuna që kanë qenë tw ndara në dy pjesë të ndryshme nga ajo që janë sot, pra mund të kenë qenë në dy bashki të ndryshme. Duke parë se çfarë është bërë deri më sot dhe duke parë se çfarë do të bëhet, a jemi ne apdejt me reformën territoriale? A do të ketë kjo ndryshime? A ka nevojë për një rishikim të kësaj strategjie apo një lloj riformatimi tjetër që t'i përputhim këto të dyja, meqenëse sapo kemi filluar me këtë projekt?

Faleminderit!

Benet Beci - Për hir të së vërtetës programi është kompozuar në momentin kur ka qenë ndarja e vjetër territoriale, por në këtë moment ne nuk kemi filluar akoma në pjesën e përzgjedhjes dhe mbledhjes së të dhënave.

Është rënë dakord dhe programi është përshtatur që partnerët tanë në të gjithë procesin të jenë njësitë e reja të qeverisë vendore, të cilat do të funksionojnë në parim si me të vjetrat, por në fakt do të jenë vetëm 61. Këta janë partnerët tanë, por procesi i aplikimit, i kërkesave dhe i përzgjedhjes është pothuajse i njëjtë, por partnerët janë të ndryshëm. Tani ne po punojmë me bashkitë e reja.

Erion Braçe - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Atëherë, kalojmë në diskutime. Kush e do fjalën?

Po, zoti Bode!

Ridvan Bode - Dua të shpreh që në fillim që ne e mbështesim këtë kredi në vijim të dy fazave të tjera për të përshpejtuar furnizimin me ujë të pijshëm të zonave rurale. Ende është jo normale, që një numër i madh i qytetarëve nuk kanë ujë të pijshëm në shtëpitë e tyre dhe mendoj se është një nga drejtimet që përmirëson dukshëm nivelin e jetesës së çdo familjeje. Duke mbështetur

këtë kredi do të dëshiroja të shpreh shqetësimin e opozitës për tri çështje që lidhen me këtë projekt dhe me rivlerësimet lokale.

Së pari, u prek këtu çështja e kritereve të miratuara dhe mbi të cilën është bërë përzgjedhja. Ne sot kemi agjenci zbatuese në komision që prezanton ligjin, ç'ka do të thotë që sot do të kishim një pamje më të qartë të shpërndarjes së investimeve për të qenë më transparent për territorin e vendit dhe për mënyrën se si janë marrë në konsideratë kriteret që janë deklaruar. Më duket se ka vend për një rishikim më efikas të përdorimit të fondeve, sepse nga relacioni morëm vesh që janë 40 milionë euro dhe përfitojnë 75 mijë banorë.

Më duket se kostoja për fitim është jo optimale, pra kemi investime në ujësjellës me kosto të lartë, ç'ka do të thotë që do implikojë çmime të larta të pagimit të ujit nga ana e qytetarëve. Në këtë drejtim do të doja të tërhiqja vëmendjen për realitetin e krijuar pas njësive të reja lokale, bashkive, të cilat ofrojnë po ashtu një mundësi shumë të madhe nga ana e agjencisë tuaj për të rikonceptuar investimet në ujin e pijshëm. Me këtë dua të them që hapet mundësia për ndërtime të ujësjellësve rajonalë dhe në këtë investim të mund të përfitojnë një numër shumë më i madh banorësh dhe të tilla investime rajonale ka me shumicë.

Është e domosdoshme që në kriteret tuaja duhet të theksohet ky element, pasi investime të vogla në një fshat të veçantë mund t'i bëjnë edhe vetë bashkitë e reja, por kur bëhet fjalë për investime rajonale që përfshijë 10, 15 apo 20 fshatra, sigurisht që ndërhyrja juaj është e domosdoshme. Ju duhet që t'i gjurmoni dhe t'i tërhiqni pikërisht këto lloj projektesh që janë me vlerë të konsiderueshme, nga të cilat përfitojnë një numër shumë i madh qytetarësh dhe që bëjnë të mundur që çmimi i ujit të jetë i përshtatshëm për t'u përballuar nga ana e qytetarëve.

Sigurisht që në fazën aktuale unë nuk besoj se ka ndonjë projekt apo studim të tillë rajonal, pasi ndarja në komuna, copëzimi ka bërë që ujësjellësit të kenë projekte për çdo fshat të veçantë ose maksimumi për dy apo për tri fshatra që përfshihen brenda territorit të të njëjtës komunë. Tani me optimizmin e burimit të ujit brenda një territori më të madh është i mundur hartimi i të tilla projekteve dhe do t'ju këshilloja, do t'ju sugjeroja që të merrni në konsideratë në radhë të parë projektet rajonale për t'i zëvendësuar në ato projekte të vogla të fshatrave të veçantë, të cilat në qoftë se do të kenë burime të veçanta uji mund të përballohen nga njësitë e reja zgjedhore.

Shqetësimi i dytë që dua të ngre ka të bëjë me ritmet e ulëta të investimeve lokale nëpër fshatra, në zona rurale.

FSHZH-ja sigurisht që në fillesën e saj është ngritur dhe i janë ato atribute pikërisht për të investuar në zonat rurale për të mbështetur me investime më të qenësishme zonat rurale. Me ndërtimin e njësive të reja sigurisht bëhet e mundur që për territorin e madh, projekte të cilat kanë qenë objekt i FSHZH-së gradualisht të jenë objekt i bashkive të reja. Ne shohim që nuk ka investime, nuk ka ujësjellës, nuk ka shtrim rrugësh, nuk ka përmirësim infrastrukture në zonat rurale. Edhe ato fonde

që janë alokuar dhe sigurisht janë në nivelin minimal të investimeve publike që ka pasur vendi edhe nga FSHZH-ja po destinohen drejt projekteve, të cilat nuk janë dhe nuk përputhen me qëllimin e operimit të FSHZH-së. Pjesa dërrmuese e investimeve sipas asaj që kemi parë, ju i keni dedikuar drejt qendrave të qyteteve për të lyer fasada, për të bërë ujësjellës, për të shtruar me mermer qendrat e qyteteve, ndërkohë që kanë mbetur të abandonuara dhe pa asnjë investim prej dy-tre vjetësh të gjitha zonat periferike. Për ne kjo përbën shqetësim, sepse qëllimi i FSHZH-së ka qenë pikërisht për të mënjanuar disbalancën e madhe në investime midis zonave urbane dhe zonave rurale dhe destinacioni juaj kanë qenë zonat rurale dhe jo palmat e rrugëve, jo mjelljet anës autostradave që kanë qenë të Ministrisë së Punëve Publike, jo qendrat e qyteteve dhe fasadave të tyre, por të tentoni drejt zonave, të cilat janë më të abandonuara dhe më të pafavorizuara.

Çështja e tretë që dua të ngre ka të bëjë me shkallën e ulët të disbursimit të fondeve të investimeve të huaja, të kredive që po miratojmë sot dhe të granteve. Është krejtësisht e papranueshme, që me një ngushtësi të tillë ekonomike që ka vendi dhe me një shterim të burimeve të brendshme për financimin e buxhitetit, pra të financave publike, niveli i disbursimit të kredive huaja, të cilat janë më të përshtatshme kanë një kupon fiks të interesit, është me afat të gjatë dhe japin financave publike një qëndrueshmëri në kohë të jenë në nivele të tilla.

Ne miratuam një ndryshim në aktin normativ të buxhetit dhe aty u hoqën 100 milionë dollarë kredi pikërisht nga këto kreditë e zhvillimit për t'u rialokuar dhe për t'u dhënë mundësinë që të merren me burimet e brendshme, me kursimet e qytetarëve.

Kjo nuk është zgjidhje e mirë dhe kjo kërkon që ju që jeni agjenci zbatuese e fondeve dhe e projekteve me financim të huaj, të programoni dhe të realizoni në përputhje me këtë kalendar që ne miratojmë sot, se ju miratoni sot kredinë dhe thoni që do të disbursojmë për kaq kohë. Kushtet dhe termat sigurisht për ne janë të përshtatshme, por kur vjen puna te shkalla e disbursimit të tyre ajo është shumë e ulët. Atë që raportuat në aktin normativ, që disbursimi i fondeve tuaja është vetëm 8% mendoj se është shifër shumë e ulët dhe kërkon edhe nga ju si agjenci zbatuese dhe nga qeveria që monitoron, që ky problem të marr fund njëherë përgjithmonë.

Faleminderit!

Erion Braçe - Faleminderit! Zoti Beci, doni të ndërhyni? Po, urdhëro!

Benet Beci - Sa për saktësim. Për sa i përket realizimit të buxhetit për investimet e huaja ne i kemi absolutisht sipas parashikimit dhe jemi shumë në rregull dhe jemi krejtësisht në ritmet e shifrave makro. Shifrat e fondit të investimeve të huaja dhe të parashikimit janë pak më shumë se sa kishim parashikuar.

Për sa i përket ndërhyrjeve në zonat rurale është e drejtë ajo që tha deputeti, pasi është një nga objektivat tona dhe ne nuk kemi hequr dorë nga ajo dhe paralelisht punojmë me të.

Projekti që kemi sjellë sot është ekzaktësisht një projekt investimi në zonat rurale, që janë ujësjellësit. Sigurisht në disa raste duke qenë institucion implementues i projekteve të qeverisë edhe në bashkëpunim me bashkitë ne bëjmë edhe investime të tjera përveçse në zonat rurale dhe nuk kemi prekur asgjë nga detyra jonë kryesore dhe programi që kemi pasur për detyrë për zonat rurale.

Për sa i përket çështjes së zonave rajonale është shumë e drejtë dhe praktikisht efiçenca më e lartë e investimit do të jetë në zonat ku ujësjellësit janë rajonalë. Në dy programet e para të realizuara disa vite më parë për fazën e parë dhe të dytë në fshatrat ne kemi testuar me shumë sukses grupimet e shumë fshatrave dhe po ta shikosh nga numri kemi mbuluar rreth 50 fshatra me 20 skema ujësjellësish.

Ndoshta nuk e përmenda në paraqitjen e mëparshme, por për ne është e domosdoshme dhe shikojmë me shumë kujdes përfshirjen në skema të ujësjellësve ruralë jo të shkëputur. Mundësisht ndarja e re territoriale do të na ndihmojë që ne ta shikojmë figurën e ndërhyrjes në mënyrë më të gjerë dhe jam krejtësisht dakord, por desha të them që ne kemi parasysh dhe do ta kemi parasysh në realizimin projektit.

Ridvan Bode - Problemin ju e keni në një konflikt dhe nuk keni programe rajonale për ujësjellës rajonalë, sepse kanë qenë të copëzuar. Ju do të filloni me disbursimet dhe me ndarjen e fondeve. Si do ta kapërceni këtë ngërç? Ky është problemi, se deri më sot nga pushteti vendor nuk ka pasur projekte rajonale, sepse ata janë kujdesur që të furnizojmë me ujë brenda përbrenda një fshat të veçantë apo maksimumi dy fshatra, ndërkohë që burimet e ujit në zonat rurale, në pjesën më dërrmuese janë burime rajonale uji, që mund të optimizohen edhe burimet ujit edhe kostot e ujësjellësve.

Si do ta kapërceni këtë? Nëse do ta ndani 40-milionëshin do të vijmë pas 5 vjetësh të tjerë dhe do të fillojmë të konceptojmë për ujësjellës rajonalë.

Të jeni të bindur që baskitë, edhe pse janë të madha, nuk mund të përballojnë kostot e ujësjellësve rajonalë, pasi janë shumë më të mëdha me kapacitetet që ato kanë dëshmuar deri më sot.

Erion Braçe - Po, urdhëroni!

Benet Beci - Pyetja është drejtë, por faza e përzgjedhjes nuk e mbart këtë shqetësim. Të gjitha studimet paraprake janë kryer për 15 muaj, që në fakt nënkupton që me bashkitë e reja, me ndërmarrjet e ujësjellësve dhe me të dhënat që kemi, të kemi mundësinë që ta realizojmë këtë gjë. Ne nuk fillojmë investimin tani dhe është e vërtetë që në qoftë se ne do të fillonim investimin menjëherë të ujësjellësve, sot nuk do ta kishin këtë pamje.

Faza e parë që fillojmë tani është pikërisht optimizmi i ndërhyrjes sa më rajonale. Ne besojmë se këtë do ta zgjidhim në momentin para ndërhyrjes së investimit dhe do ta relatojmë se në çfarë situate është.

Erion Braçe - Faleminderit!

Ka diskutime të tjera? Po, zoti Marto dhe më pas zoti Bushati!

Andrea Marto - Në fillim shprehem dakord me projektligjin.

Dua të theksoj se është hera e parë që dëgjoj nga zoti Bode se reforma administrative territoriale jep mundësi shumë të mëdha për këtë projekt dhe më në fund opozita i pranoi sukseset që mund të rezultojnë nga kjo reformë.

Në vijim të diskutimit që u bë dhe u prek edhe nga zoti Bode, edhe nga drejtuesi i agjencisë, del se ne duam t'i kemi të qëndrueshme këto investime, duhet patjetër t'i bëjmë rajonale. Ndoshta shifra me 70 skema ujësjellësish, që mund të jetë 50 apo 45, mund të mos jetë e fiksuar sepse Shqipëria është e pasur në burime ujore dhe ne do të synojmë që t'i bëjmë sa më rajonale ato edhe mundësisht të kemi ujësjellës me vetërrjedhje, qofshin këto edhe me distanca të mëdha, prandaj duhen bërë investime të tilla dhe të mos fiksohemi te 70 skema.

Unë mund të marr edhe një shembull konkret. Ne kemi zonën e Delvinës dhe pavarësisht se Delvina quhet qytet, ajo është thjesht një qytezë dhe gjysma e Shqipërisë kështu është, e gërshetuar me fshatra dhe me qyteza. Ne duke ecur me këtë termin "rurale", nuk mund të kemi projekte rajonale. Po bëre një projekt rajonal në zonën konkrete ose në shumë zona të tjera të vendit që ka burime pavarësisht distancave mund ta bëjmë skemën, por të jenë të qëndrueshme. Në Shqipëri ka shumë vende që kanë mundësi të tilla. Agjencitë e tjera shtetërore mund të japin një ndihmesë të madhe, siç është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, me qëllim që kjo situatë, të shihet që në fillim të studimeve të fizibilitetit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Po, zoti Shehu.

Sherefedin Shehu- Natyrisht, kemi të bëjmë me një projekt, që është vazhdim ose të themi më mirë, projekt i qeverisë së mëparshme, por, fatkeqësisht, ne po shikojmë se qeveria nuk ka interes për të zgjidhur problemin e ujit të pijshëm, sepse që prej dy vjetësh nuk ka ndonjë projekt të realizuar. Prova më e qartë e mungesës së vullnetit dhe të aftësisë për të bërë projekte në shërbim të qytetarit, është edhe akti normativ, që ju sapo miratuat.

Sot, ne po miratojmë një projekt prej 24 milionë eurosh. Ju, kolegë, para tri ditësh, keni votuar për t'u hequr ujësjellësve 20 milionë euro. Pra, me aktin që votuat, ju hoqët 2,8 miliardë lekë nga programi i ujësjellësve, ndërsa sot ne po marrim 24 milionë euro kredi për programin e ujësjellësve.

E para, këtu shikojmë që qeveria nuk i harmonizon burimet e financimit, por përdor burime me kosto më të lartë, ndërkohë që kishte mundësi të realizonte burime me kosto më të ulët. Kjo mundësi ishte në dorën e qeverisë dhe që të përdorte këtë burim, qeveria duhet të kishte arkëtuar të ardhura, që parashikoheshin në buxhetin e shtetit. Pra, për faji të qeverisë, si zëvendësues i financimit, gjendet kredia, që kushton më shumë se të ardhurat e buxhetit.

Pastaj, problemi i dytë, që diskutojnë kolegët në parim është i drejtë, por nuk është problem i FSHZH-së. Drejtoria që përmendët ju, zoti Marto, ka xhelozi të madhe për këta. Ka një konkurrencë të pashpallur, që pse hyni në pjesën tonë. Është e drejtë që qeveria duhet të ketë një masterplan, në të cilin të ndajë: të bëjë studime, të parapërgatitë projekte, të rrisë shkallën e dizbursimit të fondeve, sidomos kur janë grante ose kredi. Kredia që merret sot, ka të parashikuar dizbursimin edhe për këtë vit, që gjasat janë të mos dizbursohen, dhe për çdo lek apo euro që nuk dizbursohet, paguhet 0,25% kosto, që është tarifa e angazhimit. Shkalla e ulët e dizbursimit, që tha zoti Bode ka kosto, pra 8%-shi paguhet nga ne, sepse donatorët, huallënësit thonë: "Ja ku i keni paratë. Merrini dhe shpenzojini! Në qoftë se nuk jeni të zotët, do të paguani kosto, sepse ne po i mbajmë të gatshme për ju, që t'i shpenzoni". Kështu që këtu kemi dy probleme.

Problemi i tretë, që desha të nënvizoj dhe që e kam diskutuar edhe herë të tjera, është që qeveria përdor FSHZH-në, me të drejtë, për të nxitur zhvillimin e zonave të pazhvilluara, për t'i mbështetur zonat që janë më vulnerabël, prandaj quhet Fond i Zhvillimit. Mirëpo, problemi është se për këtë projekt, 10% e kostos paguhet nga qytetarët e këtyre zonave. Në rishikimin që qeveria i bëri aktit normativ, duhet të ishte angazhuar që të mos pakësonte programin e ujësjellësve, por të kompensonte kostot që paguajnë njerëzit, që rrojnë me ndihmë ekonomike, të kompensonte pagesën që bëjnë fermerët, të cilët janë fermerë për mbijetesë dhe jo të mbingarkonte qytetarët e Tiranës dhe të qyteteve të tjera, nuk bashkëfinancohen projektet e ujësjellësve. Ndërsa, në zonat rurale vazhdon një traditë e hershme. Sot, ata përballojnë vetë 10 % të kostos së projektit.

Prandaj, unë do të kërkoja, që në rishikimin e buxhetit, të shtohet 10 % e fondit, për Fondin e Zhvillimit dhe të rimbursohen pagesat e bëra nga banorët e zonave ku do të kryhen investimet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Dhe që të paguhesh ti në Tiranë.

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Më duket se shqetësimi është i njëjtë, pavarësisht retorikës politike, që kuptohet nga ana e opozitës, sepse do të bëjë detyrën, por në konceptet ekonomike jemi të qartë.

Kryefjala sot është tek efikasiteti i investimeve. Kemi investime inteligjente, kur dihet që fondet nuk janë të pashtershme. Më shumë se të flasim për realizimin e planit, duhet të flasim për efikasitetin e investimeve. Sot Shqipëria, nuk është një parajsë e infrastrukturës, kur dihet që 75% e territorit nuk është e mbuluar me kanalizime dhe as gjysma nuk furnizohet me ujë të pijshëm, në mënyrë cilësore.

Pra, problemi nuk është se cilave zona do t'u shërbejmë, problemi është se, përderisa nuk i kemi përfunduar zonat urbane me kanalizime dhe ujësjellës, patjetër që duhet një maksimizim dhe një efikasitet sa më i madh në përdorimin e fondeve publike.

Në fakt, kemi një histori suksesi me Fondin e Zhvillimit, që tregon se, në qoftë se këto investime shkojnë në vendin e duhur, pra ka efikasitet në menaxhimin e tyre, fondet gjenden, edhe fonde të huaja gjenden. Problemi ka qenë se gjithmonë nuk kemi pasur projekte të sakta për t'i shërbyer popullatës. Në qoftë se nuk zbatohen disa investime, apo nuk kryhen sot, është sepse nuk ka pasur studime të sakta për këto zona. Në këto 8 vjet, studimet e kryera nga ish-maxhoranca nuk kanë pasur një skemë të qartë, të cilën ende nuk e kemi sot, pra se si të furnizohet në mënyrë efikase qytetari shqiptar me ujë, në të njëjtën mënyrë siç largohen mbeturinat nëpërmjet kanalizimeve, prapë 100% në mënyrë efikase, në vitin 2015 në mes të Europës. Nuk mund të thuhet se është bërë punë, në qoftë se vetëm 25% e territorit mbulohet sot me kanalizime eficiente. Kjo tregon se duhet menduar në dy parametra kryesorë.

Në radhë të parë, duke pasur parasysh reformën territoriale, të mos bëjmë investime aty ku nesër nuk do të ketë një sens ekonomik për t'i hedhur këto para, sepse patjetër që paratë do të shkojnë. Nuk ka zona primare apo zona dytësore, kur kemi të bëjë me popullatën, por patjetër që, në qoftë se me 100 lekë mund t'u shërbejmë 100 qytetarëve, është më mirë se sa me 100 lekë t'u shërbejmë vetëm 2 qytetarëve. Për këtë është financa dhe prandaj jemi këtu, sepse ndryshe do të ishim në një komision tjetër. Pra, me ato para që hidhen, të maksimizojmë shërbime sa më cilësore, për sa më shumë qytetarë të Shqipërisë.

Jemi në fazën që të flasim për këtë dhe jo të shikojmë vetëm parametrat politikë apo elektoralë, që t'u shërbejmë të gjitha zonave. Nuk është problemi të shkojmë në të gjitha zonat dhe të jemi kapilarë në gjithçka, kur ende nuk kemi plotësuar arteriet kryesore: furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e mbeturinave nëpërmjet kanalizimeve. Pra, në këtë pikë kërkohet një sens ekonomik si nga Fondi i Zhvillimit, ashtu edhe nga diskutimi ynë, që kryefjala të jetë efikasiteti, të jenë investimet inteligjente në ekonomi, jo thjesht realizimi i planit, si në kohën e socializmit. Nuk duhet folur më për realizim plani, por duhet folur për investime inteligjente, për shërbime inteligjente.

Ne nuk e kemi luksin që të kemi mbuluar 100% të territorit dhe hajde të shkojmë në disa zona kapilare, sepse edhe ata njerëz kanë të drejtë. Patjetër, që kanë të drejtë për shërbime, për infrastrukturë, por me paratë që kemi, që, për fat të keq, janë të shtershme, ashtu siç janë në të gjitha qeveritë e botës, prandaj është ekonomia dhe financa, menaxhimi i burimeve të shtershme, përpiqemi, që me paratë që kemi, të maksimizojmë dhe të respektojmë donatorët e huaj me paratë që na japin, duke pasur parasysh këto dy parametra: reformën e re, siç e kemi ndërtuar dhe demografinë.

Shqipëria po ndryshon çdo ditë. Ndryshimet demografike që ka kaluar Shqipëri në këta 20 vjet, janë dramatike. Kemi ndryshime të raporteve të popullatës nga zonat rurale apo nga fshatrat, në

zona me një popullatë më të përqendruar. Të mos i quajmë më "zona rurale". Ne do ta ndryshojmë këtë leksikologji, që të mos themi më: zona rurale dhe urbane, por: zona me intensitet urban dhe zona me më pak intensitet urban. Duke e ditur që qytetarët do të gravitojnë në mënyrë të pashmangshme, pavarësisht çfarë mendon politika, ekonomistët e të tjerë, ata do të vijnë, sepse qytetarët përqendrohen. Ky është trendi.

Ende sot në botë dhe në vende të zhvilluara, nuk kanë filluar të largohen njerëzit nga zonat urbane, kështu që për shumë dekada, njerëzit në Shqipëri do të vazhdojnë të gravitojnë drejt zonave më të përqendruara, më me intensitet urban. Për këtë, mendoj se duhet një studim, të pakën ekonomik. E mirëpres shumë nga Fondi i Zhvillimit. E kemi diskutuar edhe në 2-3 takime të tjera, edhe me komisione të tjera edhe këtu.

Pra, duhet bërë një studim i investimeve inteligjente: si do të jetë nga ana demografike, ndoshta nuk ju takon vetëm juve, por mund të ngrihet një komision *ad hoc* për këtë punë. Si do të jetë demografia e Shqipërisë për 10 vjet? Pra, të mos ndërtojmë një ujësjellës në një zonë, e cila pas 10 vjetësh nuk do të ketë më njerëz. Kush do ta menaxhojë atë? Kujt do t'i shërbejë ky ujësjellës? Nuk është puna se janë paratë e të huajve dhe janë të gjermanëve. Ato janë para që na jepen ne. Me këto para mund t'i shërbejmë një zone shumë më të madhe, më afër zonave me intensitet urban.

Pra, unë e mirëpres shumë një studim dhe mendoj se duhet bërë, ndoshta jo kaq shpejt, sepse nuk është bërë gjithë këtë kohë, por të kemi një studim integral, duke pasur parasysh këto dy parametra: reformën dhe demografinë, si mund të maksimizojmë efikasitetin në shërbimin e qytetarëve me kaq para sa kemi?

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Bushati!

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho – Jo për të bërë replikë, por nuk ka nevojë për shumë studime dhe shumë inteligjencë. Nëse ujësjellësi i Tiranës kushton 100 milionë euro dhe në Tiranë jetojnë pothuajse 1 milionë banorë, 40 milionë euro janë 40% e këtij investimi dhe furnizojnë 75 mijë banorë, apo ujësjellës i të gjithë zonës së plazhit të Durrësit, apo ujësjellësi i Durrësit e kështu me radhë. Kështu që, nuk ka nevojë për shumë studime, mjafton t'i orientojmë fondet në ato projekte që i kemi prioritare sot.

Erion Braçe – Po, zoti Beci.

Astrit Beci - Unë desha të adresoja një shqetësim të përbashkët që bart procesi i përzgjedhjes këtu.

Në fakt, procesi i përzgjedhjes së ujësjellësve është, në një farë mënyre, konkurrues. Nga bashkitë e reja që sjellin kërkesat, falë sistemit të konkurrueshmërisë, në fakt, do të fitojnë ato që kanë eficiencën më të lartë. Është një mekanizëm brenda për brenda të gjithë përzgjedhjes, që niset edhe

nga kostoja, që të çon natyrshëm tek eficienca më e lartë, sepse është konkurrueshmëri në bazë të kostos për njësi, dhe të çon natyrshëm tek ujësjellësit në grupe, ose që mbulojnë një masë më të madhe të përfituesve. Kjo është mënyra e parë.

Jam dakord që duhet bërë një studim dhe ka disa studime për zonat rurale, që duhen unifikuar ose duhen konsultuar, por, mbi të gjitha, procesi bart një konkurrueshmëri, e cila në vetvete sjell eficiencë më të lartë të investimit.

Erion Braçe – Faleminderit!

Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Edhe unë, pa dashur të bëjë replikë me zotin Bushati, sepse ngjan shumë bukur të bëjmë studime, sepse flisni akoma sikur jeni në opozitë, them se ne jemi dakord me këtë projekt, duke qenë se është edhe vazhdimësi, duke qenë se shërben, të paktën, për të balancuar atë bilanc negativ që kanë investimet në ujësjellës.

Shqetësimi ynë është dhe, sigurisht, që nuk i drejtohet Fondit të Zhvillimit, sepse janë agjenci zbatuese dhe do të zbatojnë pikërisht politikat që qeveria juaj vendos të zbatojë, se pse u shkurtuan 2,8 miliardë lekë për ujësjellës, ndërkohë që mund të ishin plotësuese të fondeve që ka sot Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ka shumë projekte, për shembull, Zoti Spaho përmendi kredinë japoneze për Bashkinë e Tiranës, që qeveria për 2 vjet nuk kishte dëshirë ta zbatonte. Shpresojmë që vullneti politikë të ketë ndryshuar, të paktën, këta 2 vjet dhe ta zbatoni, sepse nuk bëhet për kryetarin e radhës së bashkisë, por bëhet për qytetarët.

Edhe një herë, problemi nuk lidhet me projektin që na sjell sot Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që është një projekt, që me zotin Beci kemi diskutuar, duke qenë se këtu janë edhe fondet e IPA-s, një vazhdimësi e projekteve, që kanë më fondet e donatorëve. Pra, lidhet me fondet e tjera komplementare, që qeveria vendos të angazhojë në këtë sektor dhe në rastin e ujësjellës kanalizimeve, që nuk plotësojnë nevojat. Pavarësisht dëshirës që mund të ketë Fondi i Zhvillimit, ai nuk zëvendësojnë dot vullnetin politik dhe angazhimet që ka qeveria për të shkurtuar fondet, pikërisht në këtë sektor.

Erion Braçe – Ju nuk keni gjë për të thënë, sepse për kredinë japoneze u bë edhe tenderi, madje u bë edhe me policë. Pse nuk u zbatua kredia japoneze?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Jo, u bë tenderi dhe u bë me policë, madje Ministria e Transporteve mbikëqyrej 24 orë me policë, kur u bë tenderi. Pse nuk u zbatua ajo, apo nuk kishit marrëdhënie të mira me zotin Basha?

A ka ndonjë diskutim tjetër? Nuk ka.

Sherefedin Shehu – A mund të bëj një diskutim, meqenëse u debatua shumë kjo e çështjeve rajonale.

Erion Braçe – E hedhim në votë projektligjin.

Sherefedin Shehu - Për të qenë të qartë, studimet rajonale i bën ministria përgjegjëse, nuk i bën Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Erion Braçe – Kush është kundër për projektligjin? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 1.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim projektligjin në tërësi.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Beci, faleminderit për prezencën tuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të qenë korrektë, para se të fillojmë, zoti Spaho, nuk e di e thatë ju apo e tha shoku Sherefedin, por me aktin normativ, nga programi "Furnizim me ujë dhe kanalizime" janë shkurtuar vetëm 2,67 miliardë lekë dhe e gjithë shuma ka qenë financim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të mbaroj Sherefedin? Ti je interesant shumë. Do të justifikosh rolin e drejtorit në parti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, 2,67 miliardë lekë Sherefedin, dhe të gjitha ishin fonde të huaja dhe jo të brendshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lexo ndonjë gjë, zoti Shehu! Je edhe drejtor tani.

Vazhdojmë me projektligjin e dytë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti, Sherefedin, nuk do të bëhesh asnjëherë. As në parti nuk të vjen radha ty, për të bërë ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk të bëjnë gjë, jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sherefedin, unë në parti kam hyrë në këmbë dhe rri në këmbë. Rri në këmbë, Sherefedin. Unë hyj dhe rri në këmbë. E di ti.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.09.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Europa për qytetarët"".

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Ridvan Bode, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Andrea Marto, Blerina Gjylameti, Ervin Koçi, Evis Kushi, Ervin Bushati, Gledion Rehovica, Gjovalin Kadeli, Luan Duzha, Jorida Tabaku, Igli Cara, Florion Mima, Sherefedin Shehu, Edmond Spaho, Liliana Elmazi, Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Koço Kokëdhima.

E ftuar:

Genta Sula – zëvendësministre e Ministrisë së Mirëqenies Sociale.

Erion Braçe - Vazhdojmë me projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Europa për qytetarët"".

Në Komisionin e Ekonomisë ndodhet për të prezantuar projektligjin, zëvendësministrja e Ministrisë së Mirëqenies Sociale, zonja Genta Sula.

Fjalën e keni ju, për të prezantuar projektligjin dhe pastaj relatori i komisionit, zonja Blerina Gjylahmeti.

Genta Sula - Ju falënderojmë për audiencën!

Me pak fjalë, projekti "Europa për qytetarët" është një projekt i Komitetit Europian.

Ky projekt ka ekzistuar edhe më parë, por këtë herë merr një frymëmarrje të re. Është riinspiruar nga ngjarjet përkujtuese të vitit 2014, siç janë: 100- vjetori i mbarimit të Luftës së Parë Botërore, 70-vjetori i mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe 25 vjetori i rënies së Murit të Berlinit. Merr një frymëmarrje dhe një qasje të re, me dy shtylla kryesore.

E para, është kujtesa që thërret vendet europiane për të kujtuar atë që ka ndodhur gjatë shekullit të 20-të, i cili ka qenë një shekull i përgjakshëm, me sisteme totalitare, me ndasitë fetare religjioze, ideologjike të fuqishme. Nuk dua të zgjatem gjatë, sepse është diçka që ne të gjithë e dimë. Edhe në frymën e re të ngjarjeve që po ndodhin, këtij projekti i është dhënë një qasje e re. Pra, ka dy dimensione.

E para, është kujtesa, për të ditur se çfarë ka ndodhur.

E dyta, është për të promovuar vlerat e reja të demokracisë, për të konsoliduar demokracitë, sidomos në vendet e reja, me demokraci të re, siç është Shqipëria. Pra, ka dy shtylla.

Ne e kemi shqyrtuar në programin tonë të qeverisë. Kujtesa për ngjarjet e sistemit totalitar që kemi kaluar, është shumë e rëndësishme.

Në qendër kemi pasur gjithmonë të mbijetuarit e sistemit, por që, njëkohësisht kemi parë edhe kujtesën historike, prandaj ministria, në bazë të fushës së veprimit të vet, ka vendosur t'i propozojë qeverisë dhe parlamentit të rihyjë në këtë program, për t'i dhënë një mundësi të re gjithë shoqatave, grupeve të interesit, historianëve, grupeve të ish-të burgosurve politikë, të rinjve, që duan të përmirësojnë qasjen në pjesëmarrjen politike, me zhvillimet demokratike.

E kemi parë si një mundësi të mirë për të për t'i dhënë një frymëmarrje të re pjesëmarrjes qytetare dhe të gjitha këtyre grupeve, që deri më sot nuk e kanë pasur këtë pjesëmarrje. Kemi shqyrtuar kostot, kriteret dhe të gjitha modalitetet e pjesëmarrjes.

Unë vetë kam kryesuar grupin e punës. Kam qenë në Bruksel. Këtë herë është Drejtoria e Përgjithshme e Punëve të Brendshme në Bruksel, nuk është më Ministria e Kulturës, sepse i është dhënë një rëndësi tjetër. Jemi konsultuar me grupet pa interes të lartë. Ata kanë shprehur dëshirën për të aplikuar, gjithnjë e më shumë.

Në kuadrin e aktiviteteve të ndryshme që po bën qeveria për kujtesën, vlen t'ju sjell në vëmendje, për shembull, punën që është bërë për të hapur për publikun vendet e vuajtjes së dënimit, po përmend burgun e Spaçit, kampin e Tepelenës, hapjen e bunkerit, bunkartit e hapur për publikun, për të parë se si është konceptuar dikur izolimi me botën dhe çfarë pasojash ka sjellë, ligji i transparencës së dosjeve, pra ka një sërë aksionesh dhe kjo vjen si një mundësi e mirë, që të gjitha grupet e interesit, të marrin pjesë në programe komunitare, në bashkëpunim me qytete të ndryshme të Europës, që kanë të njëjtat probleme, të mësojnë nga ato dhe të bëjnë diçka brenda programit të punës së tyre.

Është për t'u përmendur fakti se Shqipëria në muajin tetor bëhet anëtare vëzhguese e rrjetit europian për solidaritet dhe kujtesë. Është një rrjet që e mbajnë vendet më të fuqishme, me në krye Gjermaninë, Poloninë, Çekinë, me qendër në Varshavë, e cila rreket ta shqyrtojë historinë e shekullit XX, si një histori të përbashkët, pra jo çdo vend në mënyrë të veçantë, por duke e parë si një histori të përbashkët, për të mësuar nga njëri-tjetri, për ta plotësuar atë mozaikun historik, si dhe për të parë se si mund të ecet përpara, për të promovuar vlera të përbashkëta, gjithmonë në kuadër të integrimit të Shqipërisë në Europë.

Në kuptimin e kostove, janë 20 mijë euro në vit që Shqipëria duhet të paguajë. Qeveria merr përsipër t'i paguajë, për t'i hapur rrugë pastaj një mundësie të mirë, pra një bashkëfinancimi që do të kenë shoqatat, grupet e interesit apo grupe historianësh individë.

Ne e kemi planifikuar këtë fond në programin e ish-të përndjekurve politikë. Shpresojmë që vitin tjetër, duke firmosur IPA 2-shin, ky fond të shkojë te IPA. E mira është, që në bazë të aplikimit që do të bëjnë grupet e interesit, rreth 80% do të rikuperohen, pra do të përfitojnë ata. Kështu që ne mendojmë që për efektet që do të sjellë kostoja që implikohet, nuk është e përfillshme, por është e vlefshme.

Nëse ka ndonjë pyetje, jam gati të përgjigjem.

Erion Braçe – Faleminderit!

Po, zonja Gjylahmeti.

Blerina Gjylahmeti – Faleminderit, zoti kryetar!

Pra, kemi për shqyrtim projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Europa për qytetarët"". Bazuar në marrëveshjen kuadër të datës 22 nëntor të vitit 2004, ndërmjet Komunitetit Europian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Shqipëria merr pjesë në programin "Europa për qytetarët", sipas parimeve të përgjithshme në programet e komunitetit. Pjesëmarrja e vendit tonë në këtë program krijon mundësinë e informimit të qytetarëve për historinë, për vlerat dhe për qëllimet e BE-së, me qëllim që të promovohen vlerat e BE-së në shërbim të rritjes së mirëqenies së përgjithshme. Programi nxit pjesëmarrjen e qytetarëve në debate, zhvillon rrjetet e

ndërveprimit shoqëror për t'u dhënë mundësi qytetarëve të informohen për vendimmarrjen politike të BE-së, si dhe të promovohen mundësitë për angazhimin shoqëror dhe vullnetarizmin.

Kontributi financiar vjetor që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e përgjithshëm të BE-së, për të marrë pjesë në programin "Europa për qytetarët", do të jetë 20 mijë euro. Shqipëria do të vendosë strukturat dhe mekanizmat përkatës në nivelin kombëtar dhe do të miratojë të gjitha masat e nevojshme për koordinimin dhe organizimin e aktiviteteve, për të zbatuar programin. Në veçanti, Shqipëria do të marrë përsipër të krijojë një pikë kontakti "Europa për Qytetarët", në përputhje me udhëzimin e parashikuar nga komisioni. Ky kontribut financiar i vendit tonë do t'i shtohet shumës së rezervuar çdo vit në buxhetin e përgjithshëm të BE-së, duke krijuar mundësi për zbatimin e programit.

Si përfundim, pjesëmarrja në programin "Europa për Qytetarët" do të ndihmojë në njohjen më të mirë nga qytetarët të veprimtarisë së BE-së, duke i shërbyer integrimit të vendit tonë në BE. Prandaj, i propozoj komisionit miratimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylahmeti!

A ka pyetje? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Në lidhje me këtë projektligj, komisioni ynë është komision për dhënie mendimi, kështu që do të kemi vetëm një votim për miratimin në parim të tij. Më pas, do të bëjmë relacion për komisionin përgjegjës, që është Komisioni i Integrimit.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA